



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 15.12.2020

R A P O R T

PËR DEKRETIN NR. 11 866, DATË 11.12.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 137/2020 “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”

I. HYRJE.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 15 dhjetor 2020, shqyrtoi dekretin nr.11 866, datë 11.12.2020, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”.

Komisioni caktoi relator, për këtë dekret, z. Anastas Angjeli.

Dekreti u shqyrtua në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 32-38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit. Mbështetur në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, dekreti u shqyrtua vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm:

Nga Presidenca:

- Z. Petraq Milo - Keshilltar i Presidentit për Ekonominë;
- Z. Bledar Dervishaj - Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Anila Denaj – Ministre;
- Znj. Mimoza Dhembli - Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit;
- Z. Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike;
- Z. Endrit Lami - Drejtor i Analizave Makroekonomike dhe Statistikave.

II. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji.

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.
2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.
3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.

9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

III. ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.

Dekreti nr.11 866, datë 11.12.2020, i Presidentit të Republikës, shoqërohet me arsyetimin për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”. Ky arsyetim paraqitet në dy aspekte: në aspektin ekonomik dhe në aspektin ligjor.

III.1. Në aspektin ekonomik, dekreti paraqet argumentet për kthimin e ligjit, si më poshtë:

Nga vlerësimi i parashikimeve ekonomike, të formalizuara përmes ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, në raport me synimet e deklaruara të Qeverisë dhe veçanërisht në analizë të gjendjes ekonomike të vendit tonë, krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 dhe përmasave që kjo gjendje pandemie po merr, rezulton se, buxheti i vitit 2021:

- Nuk parashikon mbështetje të mjaftueshme dhe të nevojshme për të përballuar pandeminë Covid-19 dhe pasojat e saj.
- Nuk ka programe për të mbështetur biznesin e vogël, fasoneritë, turzimin dhe eksportuesit, veçanërisht për të përballuar pasojat e papunësisë, apo ndërprerjes së aktivitetit për shkak të pandemisë. Sidomos në kushtet kur sipas statistikave zyrtare, numri i vendeve të punës të humbura llogaritet në mbi 50 000;
- Nuk ka zbatuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për të mos zgjeruar projektet PPP si me mbështetje buxhetore, dhe ato me ofertë të pakërkuar;
- Nuk ka një objektiv për uljen e varfërisë për grupet më në nevojë;
- Nuk ka objektiv për uljen e papunësisë dhe rritjen e punësimit;
- Nuk ka një projektplan se si do të ulet borxhi i rritur publik;
- Nuk ka një program masash për uljen e detyrimeve të prapambetura;
- Është një buxhet jo realist për sa i përket parashikimit të rritjes ekonomike dhe të ardhurave;
- Nuk ka një program masash për përmirësimin e treguesve financiarë të kompanive shtetërore;
- Politikat fiskale vazhdojnë të jenë të diferencuara si:
 - i) rritja e pagave;
 - ii) tatim fitimi;

- iii) amnistia fiskale; dhe
- iv) programimi i investimeve publike.

Për më tepër, rritja ekonomike si dhe qëndrueshmëria makroekonomike në Shqipëri është vazhdimisht e ekspozuar ndaj:

- riskut që rrjedh nga borxhi i lartë publik;
- rritjes së detyrimeve të prapambetura;
- mungesës së zbatimit të ligjit dhe luftës ndaj fenomenit të korrupsionit;
- rritjes së projekteve koncesionare dhe PPP;
- performancës së ulët financiare të kompanive publike, si dhe politikave të gabuara të qeverisjes;
- rreziqeve në rritje të ekonomive të vendeve partnereve.

Konkretisht, gjetjet themelore të mësipërme, mbështeten në arsyetimet si më poshtë:

- 1.** Treguesit ekonomikë dhe fiskalë të realizimit të vitit 2020 janë negativë.
- 2.** Parashikimet e treguesve ekonomikë për vitin fiskal 2020 mbeten negative, ndërsa ato të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë jorealiste.
- 3.** Parashikimet e treguesve ekonomikë dhe fiskalë në buxhetin e vitit 2021 mbeten jorealiste.
- 4.** Masat ndaj pandemisë për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, si dhe rimëkëmbjen ekonomike në buxhetin e vitit 2020 dhe 2021 janë të pamjaftueshme.
- 5.** Thellimi i varfërisë në vitin 2021.
- 6.** Rritja e papunësisë dhe ulja e punësimit.
- 7.** Niveli i lartë dhe raportimi joreal i borxhit publik.
- 8.** Mbështetja jo e mjaftueshme për biznesin e vogël, sektorin fason, eksportet dhe turizmin.
- 9.** Rritja e detyrimeve të papaguara.
- 10.** Rritja e kostove të PPP-ve me mbështetje buxhetore, si dhe rritja potenciale e detyrimeve ndaj PPP-ve me ofertë të pakërkuar.
- 11.** Detyrimet e kompanive shtetërore për pagesën e nënhuasë, si dhe të garancive shtetërore përbëjnë një rrezik të shtuar fiskal.
- 12.** Politika fiskale të direfencuara dhe jo eficiente në paga, taksim, administrimin e investimeve publike.

III.2. Në aspektin ligjor, dekreti paraqet argumentet për kthimin e ligjit, si më poshtë:

Ligji nr.137/2020 bie ndesh me nenet 4, 11 dhe 59 të Kushtetutës dhe parimet e funksionimit të shtetit të së drejtës.

Neni 4 i Kushtetutës parashikon se:

- “1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.
2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”.

Neni 11 i Kushtetutës parashikon se:

“Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.”.

Neni 59 i Kushtetutës parashikon se:

“1. Shteti, **brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon**, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;

b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;

c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;

ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

2. Përbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. **Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.”.**

Sa më sipër, është detyrë e ligjvënësit, që në çdo ligj që miraton, të kujdeset që të respektohen këto kërkesa dhe parime të sanksionuara në Kushtetutë. Veçanërisht kjo është e domosdoshme kur bëhet fjalë për miratimin e ligjit buxhetor, që përcakton shpërndarjen direkte të të ardhurave publike përgjatë një viti.

Alokimi i fondeve buxhetore, por mbi të gjitha dhe mënyra se si analizohen dhe orientohen politikatat ekonomike dhe fiskale, lidhet drejtpërsëdrejti edhe me mundësimin e respektimit të parimeve të mbrojtura nga Kushtetuta e vendit.

Për pasojë, ky buxhet nuk mundëson mbështetjen e nevojshme buxhetore, për të bërë çfarë është e mundur, më së pari, për ruajtjen e shëndetit të popullsisë nga sëmundja infektive Covid-19, si dhe nuk garanton mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor përmes krijimit të kushteve për punësim, për shëndetësi cilësore dhe as për mirëqënie.

Në përfundim, dekreti paraqet nevojën për disa përmirësime në ligj, në këto aspekte:

- Vendosja e rregullit fiskal, i cili do të përcaktojë një tavan të borxhit publik të vendosur me ligj, e cila është një masë shumë e domosdoshme.
- Përmirësimi i ligjit në përputhje me:
 - nevojat reale të shoqërisë shqiptare në këtë situatë të rëndë krize të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19;
 - nevojës për masa urgjente për përmirësimin e sistemit shëndetësor, në kuadër të përballimit të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19;
 - nevojës për të rivlerësuar edhe një herë mbështetjen ekonomike të familjeve shqiptare dhe të sektorëve të ekonomisë më të prekur nga pandemia;
 - nevojës për të respektuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare që asistojnë dhe monitorojnë Shqipërinë.

IV. Diskutimi në Komision.

Këshilltarët e Presidentit të Republikës paraqitën dekretin dhe arsyet e kthimit të tij. Ata analizuan, në detaj, secilin prej argumenteve ekonomike e ligjore të Presidentit për kthimin e ligjit.

Relatori paraqiti opinionin e tij kundër dekretit në përgjithësi, si dhe kundër çdo argumenti të paraqitur në arsyetimin e dekretit. Mendimi i relatorit u mbështet nga shumica e anëtarëve të Komisionit, ndaj më poshtë paraqitet si mendimi i Komisionit:

IV.1. Lidhur me argumentet në aspektin ekonomik.

Politikat ekonomike e sociale, të cilat analizohen në detaj në arsyetimin e dekretit, nuk përbëjnë argument për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

Kompetencat e Presidentit të Republikës përcaktohen në nenin 92 të Kushtetutës. Neni 94 i Kushtetutës thekson se “Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin vetëm nëse bie ndesh me kushtetutën dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të.

Politikat shtetërore ekonomike, sociale, mjedisore etj, janë atribut i Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.

Kjo kompetencë del akoma më e qartë po t’i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Në vendimin nr. 15/2010 të kësaj Gjykate theksohet se:

“Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa e lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.”.

Në vijim të kësaj analize, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2/2013, shprehet se:

“Gjykata vlerëson se interesi publik, së pari, është i lidhur drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit dhe mbajtjen në kontroll të borxhit publik nga qeveria. Kjo e fundit është përgjegjëse për stabilitetin ekonomiko-financiar të vendit dhe për këtë arsye ka detyrimin të ndërhyjë në çdo rast kur një gjë e tillë rrezikon të përkeqësohet. Qëndrueshmëria e buxhetit të shtetit është e rëndësishme të garantohet në çdo kohë, por ajo merr një rëndësi të veçantë gjatë periudhave të vështira që diktohen nga kriza ekonomike globale, prej së cilës nuk mund të përjashtohet sistemi ekonomiko-financiar shqiptar. Parë në këtë këndvështrim, është në interesin e të gjithë shtetasve marrja e çdo mase të nevojshme ekonomiko-financiare me qëllim shmangien e rreziqeve potenciale të mosfunksionimit të skemës së buxhetit shtetëror.”.

Për sa më sipër, është detyrë dhe kompetencë ekskluzive e Këshillit të Ministrave që, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit ekonomiko-financiar të vendit dhe të qëndrueshmërisë së buxhetit të shtetit, të hartojë politika ekonomike e sociale, bazuar në programin e tij ekonomik, në prioritetet strategjike dhe në zhvillimet ekonomike kombëtare e ndërkombëtare, duke synuar mbrojtjen e interesit publik.

IV.2. Lidhur me argumentet në aspektin ligjor.

Arsyetimi i dekretit për kthimin e ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” nuk i referohet neneve 155-161 të pjesës së trembëdhjetë “Financat publike” të kushtetutës. Ky arsyetim evidenton se ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” bie ndesh me nenet 4, 11 dhe 59 të kushtetutës. Lidhur me këtë konstatim të dekretit, Komisioni është i mendimit se:

Së pari, lidhur me argumentin që ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” bie ndesh nenin 4 të Kushtetutës:

Ligji për buxhetin e vitit 2021 është në pajtueshmëri të plotë me parimet e shtetit të së drejtës dhe të kushtetueshmërisë, të parashikuara në nenin 4 të Kushtetutës.

Së dyti, lidhur me argumentin që ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” bie ndesh nenin 11 të Kushtetutës:

Ligji për buxhetin e vitit 2021 është në pajtueshmëri të plotë me parimin që sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike, të përcaktuara në nenin 11 të Kushtetutës.

Së treti, lidhur me argumentin që ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” bie ndesh nenin 59 të Kushtetutës:

Ky nen parashikon një sërë objektivash sociale, si nxitjen e punësimit, përmirësimin e standardit të sistemit shëndetësor; përmirësimin e politikave në arsim e mjedis, përmirësimin e skemave ujitëse, rritjen e përkujdesjes sociale etj.

Ligji për buxhetin e vitit 2021 është në pajtueshmëri të plotë me nenin 59 të Kushtetutës. Objektivat sociale do të mbështeten nëpërmjet zbatimit të politikave buxhetore për rritjen e të ardhurave dhe kufizimin e shpenzimeve, rritjen e investimeve publike, vijimin e reformave strukturore në ekonomi etj.

Neni 59 i kushtetutës nuk kërkon që këto objektiva sociale të realizohen në masën 100 për qind, pasi kjo është e pamundur. Aq më tepër kur gjatë vitit 2021 ekzistojnë kufizime për shkak të situatës së pandemisë shëndetësore. Ky nen kërkon që objektivat sociale shteti t'i realizojë brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private. Për këtë arsye, në këtë nen përcaktohet se:

“Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektivave.”.

Si rrjedhojë, politikat e buxhetit 2021 mbështesin kërkesat e parashikuara në nenin 59 të kushtetutës.

IV.3. Argumente të detajuara në aspektin ekonomik.

Argumenti 1.

- *(Buxheti 2021) nuk parashikon mbështetje të mjaftueshme dhe të nevojshme për të përballuar pandeminë Covid-19 dhe pasojat e saj;*
- *Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, pa rritjen e pagave të personelit mjekësor për vitin 2021, është 66.1 miliard lekë (përfshirë edhe rimbursimin) ose një rritje vetëm 1.0% krahasuar me buxhetin e vitit 2020 në 65.4 miliard lekë.*
- *Fondet buxhetore direkte për shëndetësinë për t'iu përgjigjur pasojave negative në rritje të pandemisë për vitin 2021 janë parashikuar vetëm 7.2 miliard lekë (6 miliardë lekë për shpenzime shëndetësore dhe 1.2 miliardë lekë për rimbursimin e barnave).*

Mendimi i Komisionit:

Së pari, argumentet financiare mbi pretendimin se “Shëndetësia nuk mbështetet mjaftueshëm për përballimin e pandemisë COVID-19” nuk janë të sakta, pasi për funksionin e Shëndetësisë:

- Në vitin 2019 janë shpenzuar 51.1 miliardë lekë ose 3% e PBB;
- Në vitin 2020 planifikohen të shpenzohen rreth 57.7 miliardë lekë ose 3.4% e PBB;
- Në vitin 2021 planifikohen të shpenzohen rreth 61.9 miliardë lekë ose 3.7% e PBB.

Pra, siç shihet qartë, buxheti për Shëndetësinë në vitin 2021 rritet në vlerë absolute me 4.2 miliardë lekë ose me rreth 7.3% krahasuar me planin e vitit 2021. Edhe nëse këtë krahasim do ta vendosnim në terma realë, rritja e buxhetit të Shëndetësisë në vitin 2021 është 0.3% e PBB.

Më tej, shpenzimet për Shëndetësinë gjatë vitit 2021 planifikohen në nivelin 3.7 % të PBB. Ky nivel është më i madhi i këtyre 30 viteve, pasi historiku i shpenzimeve për këtë sektor, sidomos deri në vitin 2013, maksimumin më të lartë e kanë pasur 2.7% të PBB.

Gjithashtu, në raportet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin në parim dhe nen për nen të projektligjit për buxhetin e vitit 2021, janë pasqyruar një sërë politikat mbështetëse për sektorin e shëndetësisë, si parashikimi i fondit prej 1.5 miliardë lekësh për vaksinën anti-COVID; rritja me 40 për qind e pagave për mjekët, infermierët dhe laborantët; parashikimi i fondit prej 1.2 miliardë lekësh, për paketën e rimbursimit të medikamenteve për kurimin nga pandemia Covid-19 etj.

Së dyti, në argumentimin e dekretit merret i mirëqenë fakti se pandemia COVID-19 do të persitohet në gjatë gjithë vitit 2021, ndërkohë që situata aktuale në botë është shumë shpresëdhënëse, pasi vaksinat kundër COVID-19 ose janë miratuar për përdorim, ose janë drejt përfundimit të fazës miratuese nga autoritetet respektive. Janë pikërisht këto zhvillime që kanë ndikuar dhe në parashikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2021, ku një pjesë e konsiderueshme e fondeve për luftën ndaj COVID-19 do të alokohen për blerjen e vaksinës kundër saj.

Së treti, është për t'u ritheksuar edhe njëherë fakti se pandemia e shkaktuar nga COVID-19 ka vënë në vështirësi vendet e zhvilluara të Europës dhe të Amerikës Veriore që në fillimet e saj dhe, aktualisht, këto vende po hasin vështirësi të konsiderueshme në përballimin e flukseve të pacientëve të infektuar nga COVID-19 në strukturat shëndetësore, pavarësisht faktit se shpenzimet për sektorin e shëndetësisë në këto vende janë rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 2020 dhe vitit të ardhshëm. Kjo do të thotë që rritja disproporcionale e shpenzimeve për sektorin e shëndetësisë, për përballimin e pandemisë COVID-19, nuk ka qënë çelësi i vetëm për përballimin me sukses të pandemisë në këto vende dhe sigurisht në vendin tonë. Masat e tjera të marra si: higjiena personale, mbajtja e maskave, kufizimet e lëvizjes së qytetarëve, kufizimet e bizneseve etj. kanë rezultuar njësoj efektive në mbajtjen e pandemisë COVID-19 në shifra të përbalueshme për sistemet shëndetësore respektive.

Argumenti 2:

Nuk ka një projektplan se si do të ulet borxhi i rritur publik.

Mendimi i Komisionit:

Pas rritjes së deficitit dhe borxhit publik në vitin 2020, rritje e cila ishte e nevojshme për të amortizuar goditjet që mori ekonomia e vendit nga pandemia, prej vitit 2021 e për periudhën afatmesme, borxhi publik u targetua me rënie në raport me PBB. Kjo rënie është në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskale të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Rritja e borxhit publik është e përkohshme, me synim amortizimin e goditjeve negative dhe stabilizimin e rritjes ekonomike të vendit.

Për periudhën afatmesme, politika fiskale do t'i rikthehet konsolidimit fiskal dhe rivendosjes së borxhit publik në një trajektore të qartë rënëse. Plani më kryesor për uljen e borxhit janë pikërisht buxheti vjetor 2021 dhe ai afatmesën 2022-2024. Për të forcuar disiplinën fiskale dhe për të rritur kredibilitetin e saj, në korrik të vitit 2020 u bë edhe një amendim tjetër i ligjit organik të buxhetit, ku u përfshi një rregull i ri fiskal, ai i ankorimit të balancës primare pozitive, duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim.

Argumenti 3.

Fondet për ndihmën ekonomike janë rritur me 2.5 miliardë lekë, por përsëri niveli i ndihmës ekonomike mbetet mjaft i ulët (në tremujorin e II-të të vitit 2020 është 4 965 lekë në muaj për familje). Numri i familjeve

në ndihmë ekonomike parashikohet të rritet në 66 000 familje në periudhën 2021-2023, në një kohë që sipas INSTAT numri i tyre në Tremujorin e II të vitit 2020 është 63 670 familje. Në tre vitet ardhshme numri i tyre do të rritet vetëm 2 330 familje.

Mendimi i Komisionit:

Skema e ndihmës ekonomike po i nënshtrohet një reforme për “pastrimin” nga abuzuesit, që prej vitesh kanë përfituar në mënyrë të padrejtë prej saj. Në vitin 2021, shuma e alokuar për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe familjet që përfitojnë Ndhimën Ekonomike rritet në mënyrë të konsiderueshme me 3.7 miliardë lekë krahasuar me planifikimin e vitit 2020. Kjo rritje vjen si pasojë e parashikimeve për zgjerimin e numrit të përfituesve të skemës së Ndhimës Ekonomike, si dhe për rritjen e masës së ndihmës ekonomike për këtë kategori.

Për vitin 2021 parashikohen edhe disa masa të tjera për trajtimin e familjeve në nevojë, si:

- Fondi i nxitjes së punësimit rritet me rreth 80 milionë lekë, krahasuar me vitin 2020, duke arritur nivelin prej 570 milionë lekësh në vitin 2021, që targeton dukshëm më shumë të punësuar gjatë vitit 2021;
- Fondi për Ndërmarrjet Sociale parashikohet rreth 120 milionë lekë, duke synuar punësimin e 250 të papunëve nga shtresat e marxhinalizuara gjatë vitit 2021;
- Rreth 250 milionë lekë më shumë për mbështetjen e SME-ve gjatë vitit 2021, ku me financimin e rreth 400 SME më shumë se viti 2020, do të mundësohet rritja e numrit të të punësuarve në këto biznese;
- Mbështetja në rritje e fermerëve shqiptarë gjatë vitit 2021, ku alokohen 1 miliardë lekë për skemën e subvencionimit të naftës në bujqësi, e cila ofron premisa më të mëdha për këtë sektor në lidhje me rritjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe rritjen e punësimit në këtë sektor.

Argumenti 4:

Buxheti i vitit 2021 ka një fond të papërfillshëm, të dedikuar për mbështetjen e biznesit. Nuk ka fonde për të ndihmuar për të dalë nga kriza e thellë biznesin e vogël, turizmin, fasonët dhe sipërmarrjet eksportuese.

Mendimi i Komisionit:

Krahas politikave të renditura në pikën më lart, gjatë vitit 2021 do të aplikohen një sërë politikash në mbështetje të biznesit, turizmit, fasonëve dhe sipërmarrjeve eksportuese. Këto politika janë evidentuar qartë në raportet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin në parim dhe nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”. Disa nga këto politika janë heqja e tatimit mbi fitimin për bizneset me qarkullim vjetor 0-14 milionë lekë, përjashtimi nga TVSH i bizneseve me qarkullim vjetor deri në 10 milionë lekë, mbështetja e pushtetit vendor për zhvillimin e turizmit etj.

Gjithashtu, buxheti i shtetit ka dhënë një mbështetje të konsiderueshme për të gjitha bizneset e prekura nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Në vitin 2021 parashikohet një situatë më e favorshme për biznesin, që do të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike. Kjo pritshmëri pozitive për ekonominë e Shqipërisë, përkthehet në situatë më të favorshme financiare për bizneset vendase, që do nuk do të kenë nevojë për ndihmë shtetërore, sikurse përfituan gjatë vitit 2020.

Argumenti 5:

Buxheti i vitit 2021 nuk planifikon as indeksim dhe as rritje të pagës për administratën publike, përveç punonjësve të arsimit dhe shëndetësisë.

Mendimi i Komisionit:

Pandemia COVID-19 ka sjellë vështirësi të shtuara në punën e stafëve shëndetësore dhe arsimore, të cilat duhen shpërblyer më së miri. Këtij argumenti i shtohet dhe fakti se sektorët e arsimit dhe shëndetësisë janë dhe do të jenë sektorë prioritarë. Numri i stafit arsimor dhe shëndetësor përbën rreth 40 % të totalit të punonjësve buxhetorë të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Pavarësisht kësaj, pagat e sektorëve të tjerë si: Drejtësia, Rendi Publik, Mbrojtja, Shërbimi i Jashtëm janë rritur në mënyrë të konsiderueshme prej vitit 2013. Këtu duhet të shtojmë edhe efektet pozitive që dha ndryshimi i tatimit mbi të ardhurat personale në vitin 2014, i cili solli rritje të pagës neto për punonjësit me paga relativisht të ulëta. Ndikim pozitiv pritet të ketë edhe rritja e pagës minimale nga 26 mijë lekë, në 30 mijë lekë.

Argumenti 6:

Buxheti i vitit 2021 nuk planifikon rritje reale të pensioneve, por vetëm indeksim të tyre në masën 2.5 %.

Mendimi i Komisionit:

Me reformën në ligjin e Sigurimeve Shoqërore të vitit 2015, në aktet ligjore respektive është sanksionuar se pensionet e pleqërisë do të indeksohen me inflacionin e vitit të kaluar dhe nuk lejohet rritje përtej këtij niveli. Kjo masë ka ardhur edhe si rekomandim i institucioneve ndërkombëtare, si FMN e Banka Botërore, me qëllim mbajtjen nën kontroll të kësaj skeme, e cila i kushton buxhetit të shtetit gati 1/3 e shpenzimeve totale të saj. Çdo politikë ekspansioniste (me rritje pensionesh përtej mundësive fiskale të vendit) rrezikon ta kolapsojë këtë skemë, duke qënë se kostot respektive janë të papërbalueshme.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, Këshilli i Ministrave, brenda mundësive të tij, ka ofruar një bonus përgjatë periudhës 2013-2019 për pensionistët gjatë muajit dhjetor dhe parashikon sërish ta ndërmarrë këtë masë gjatë vitit 2020. Kjo shtresë përfiton edhe skema kurimi dhe trajtimi me ilaçe falas nga sistemi i kujdesit shëndetësor, të cilat vijnë gjithnjë e në rritje, duke e lehtësuar barrën financiare për këtë kategori.

Argumenti 7:

Një risk të lartë mbart mosrealizimi i objektivit të uljes së borxhit, për shkak të ngadalësimit të rritjes ekonomike, të rritjes së detyrimeve të institucioneve publike dhe ndërmarrjeve shtetërore, si dhe rritjes së detyrimeve ndaj PPP-ve me mbështetje buxhetore dhe atyre me ofertë të pakërkuar.

Mendimi i Komisionit:

Me ndryshimin e ligjit për koncesionet dhe PPP-të në vitin 2019, oferta e pakërkuar u kufizua shumë, si procedurë ligjore.

Në vitin 2021, projektet me mbështetje buxhetore mbeten të njëjta dhe nuk parashikohet asnjë projekt i ri. Këto projekte ofrojnë asete dhe shërbime publike, të cilat nuk do ishin të mundura nëpërmjet metodës së prokurimit publik, si pasojë e kufizimeve buxhetore. Mjafton të përmendim këtu Rrugën e Arbrit, PPP-të në shëndetësi, PPP-të për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e 17 shkollave parauniversitare në Tiranë, PPP-të në fushën e menaxhimit të mbetjeve etj. Pasja e këtyre aseteve dhe shërbimeve publike me cilësinë e kërkuar, do të sjellë incentivat e duhura për rritjen ekonomike të vendit në vijimësi, si dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Ndaj projektet PPP nuk duhet të shihen vetëm me prizmin e një “barre” për buxhetin e shtetit, por si një mundësi për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë.

Pavarësisht argumenteve më sipër, nëse situata buxhetore do të jetë e pafavorshme, do të veprohet sikurse u veprua në vitin 2020, ku pagesat buxhetore për projektet PPP u reduktuan, duke riskeduluar pagesat aty ku ishte e mundur me kontraktorët për periudha të mëvonshme.

Argumenti 8:

Buxheti 2021 është një buxhet jo realist për sa i përket parashikimit të rritjes ekonomike.

Mendimi i Komisionit:

Parashikimet makroekonomike, mbi të cilat bazohet buxheti i vitit 2021 janë përgjithësisht realiste.

Është e vërtetë që kundrejt FMN ka një diferencë relativisht të vogël (krahasimisht me magnitudën e parashikimit pikëson) sa i takon projeksioneve të rritjes reale për vitin 2020. Konkretisht, FMN parashikon një

recension prej -7.5 %, ndërsa Këshilli i Ministrave një recension prej - 6.1%. Deri tani, parashikimet janë që rezultati final i vitit 2020 të jetë më pranë parashikimit të Këshillit të Ministrave. Megjithatë, kjo diferencë nuk është e konsiderueshme.

Për sa i takon projeksioneve të rritjes reale të PBB për vitin buxhetor 2021 dhe vitet buxhetore 2022-2023, si dhe parashikimit të PBB nominale, projeksionet e Këshillit të Ministrave janë tërësisht në të njëjtën linjë me ato respektive më të fundit të FMN.

Për sa i takon projeksioneve të PBB nominale, e cila përbën variablin më themelor të planifikimit buxhetor vjetor dhe afatmesëm, në vitin 2016 u bënë një sërë amendimesh të rëndësishme në Ligjin Organik të Buxhetit. Në këtë ligj u përfshi një set rregullash fiskalë. Projeksionet e PBB nominale janë të detyrueshme me ligj që të ankorohen me ato respektive më të fundit të FMN. Kjo kërkesë është plotësuar dhe është dokumentuar qartësisht në relacionin shoqërues të projektbuxhetit 2021.

Argumenti 9:

Nuk ka objektiv për uljen e papunësisë dhe rritjen e punësimit.

Mendimi i Komisionit:

Përgjithësisht në ekonomitë e “tregut të lirë”, dhe për më tepër në vende të cilat kanë një buxhet (qeveri) relativisht të vogël, si në rastin e vendit tonë, ku buxheti është rreth 30 % e PBB, nuk parashikohet si objektiv i drejtpërdrejtë (eksplisit) targetimi i një niveli të caktuar të shkallës së papunësisë apo punësimit. Kjo për arsye se nuk është ekonomikisht e llogjikshme dhe e realizueshme apo qasje e qëndrueshme si për buxhetin vjetor, ashtu edhe atë afatmesëm. Edhe projektbuxheti 2021, në linjë me këtë qasje të ekonomiksit publik, nuk përcakton një objektiv të tillë.

Objektivat kryesorë të politikës fiskale (deficiti fiskal, balanca primare, balanca korrente, investimet publike, etj) të materializuara në buxhetin 2021, në vijimësi këto të politikës fiskale të iniciuar dhe ndjekur edhe përgjatë vitit 2020, në kundërpërgjigje të dy goditjeve të njëpasnjëshme (veçanërisht ajo e pandemisë), janë përcaktuar të tillë që të mundësojnë në një mënyrë optimale funksionin “stabilizues” që mund dhe duhet të ketë buxheti i shtetit në raste të tilla goditjesh tejet të forta dhe të përkoshme. Pra, politika fiskale, e materializuar në këtë buxhet, synon të mundësojë një “stabilizim” të rritjes ekonomike dhe të aktivitetit ekonomik e rrjedhimisht edhe të tregjeve kryesore të ekonomisë, ku ndër më kryesorët është edhe “tregu i punës”. Ky funksion “stabilizues” i politikës fiskale dhe buxhetit të shtetit mund dhe duhet të kryhet deri në atë masë optimale, ku nuk rrezikohet qëndrueshmëria afatmesme dhe afatgjatë e financave publike dhe stabilitetit makroekonomik në tërësi. Ky kriter kryesor ka udhëhequr politikën fiskale në projektbuxhetin 2021. Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë të gjithë variablat makroekonomikë dhe ndërveprimet e tyre dhe duke faktorizuar edhe politikën fiskale të materializuar në këtë buxhet, në relacionin shoqërues të tij është parashikuar (por jo targetuar, pra nuk është një objektiv eksplisit i buxhetit) që papunësia mesatare e vitit 2021

do të zbresë në rreth 12.2 %, nga 13.6 % e parashikuar për vitin 2020 apo nga 12.9 % e rezultuar për vitin 2019.

Argumenti 10.

Nuk ka një program masash për uljen e detyrimeve të prapambetura.

Mendimi i Komisionit:

Një nga çështjet problematike në sistemin tonë buxhetor, ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara përpara vitit 2014. Si rezultat i masave të marra nga Këshilli i Ministrave për këtë çështje, u arrit që brenda dy viteve (2014-2015), të shlyhen të gjitha detyrimet e prapambetura të raportuara, në vlerën 56.6 miliardë lekë.

Për sa i përket procesit të ndjekjes, monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të reja të prapambetura, që prej vitit 2016, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë një monitorim intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore, mbi bazën e një skeduli tremujor periodik.

Pas implementimit të plotë të sistemit të ri informatik financiar të Qeverisë AFMIS, parashikuar për në Janar 2021, respektimi i angazhimeve financiare të institucioneve buxhetore do të garantohet përmes monitorimit dhe kontrollit të automatizuar elektronik, në kohë reale.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020” të përfshijnë programe auditimi për analizën dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësive publike. Detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësive publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.

Argumenti 11.

Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjistikës kryesisht me nënhatë e KESH, OSHEE dhe OST, pushteti vendor dhe sektori i ujësjellësve. Ndërmarrjet shtetërore nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor që t’i kthejnë fondet e marra hua. Garancitë shtetërore paraqesin një risk të shtuar në administrimin e tyre, si rezultat i situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjistik si dhe sektori i ujësjellësve.

Mendimi i Komisionit:

Sektori i ndërmarrjeve shtetërore dhe, kryesisht, ndërmarrjet që operojnë në sektorin e energjisë kanë qenë dhe mbeten nën monitorimin e vazhdueshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke marrë parasysh ndikimin e ndjeshëm fiskal dhe në ekonomi të këtij sektori kyç. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OSHEE dhe OST. Në kuadër të reformës së sektorit të energjisë është arritur një progres i konsiderueshëm i objektivave operacionalë dhe financiarë, të synuar nga kjo reformë.

Për vitin 2021, parashikimet e kompanive dhe monitorimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të fokusohen në garantimin e objektivit madhor për një performancë të shëndetshme të sektorit, përmes:

- (i) ruajtjes së një rezultati neto të qëndrueshëm, në nivelet e dakordësuara me Bankën Botërore, prej 3-5 miliard lekë, që nuk rrezikon buxhetin për sektorët e tjerë prioritarë dhe
- (ii) mbajtjen e një rezerve për përballimin e vulnerabilitetit ndaj kushteve meteorologjike të paparashikuara.

Referuar Planit të Konsolidimit Financiar për Sektorin Publik Elektroenergjitik, miratuar përmes VKM nr.253 datë 24.4.2019, masat financiare të parashikuara nga Këshilli i Ministrave si në drejtim të kompanive, ashtu edhe në drejtim të tregut, do të shërbejnë në mënyrë që:

- Sektori elektroenergjitik të mos përbëjë rrezik fiskal serioz dhe të sigurojë vetëqëndrueshmëri përtej vitit 2020.
- Të tërhiqen investimet e sektorit privat në sektorin e energjisë elektrike në një mjedis konkurrues, efikas dhe të favorshëm;
- Të rriten siguria e rrjetit dhe furnizimi me energji elektrike nëpërmjet përdorimit të burimeve alternative të prodhimit të energjisë

Mbi këto baza, pritshmëritë për vitin 2021 janë për një rezultat financiar pozitiv të sektorit, që është i rëndësishëm për përballimin e situatave të vështira të motit pa rënduar buxhetin e shtetit.

Argumenti 12.

Buxheti 2021 është një buxhet jo realist për sa i përket parashikimit të rritjes ekonomike dhe të ardhurave.

Mendimi i Komisionit:

Të ardhurat e buxhetit për vitin 2021 mbështeten në llogaritje realiste dhe marrin në konsideratë faktorët që pritet të ndikojnë ecurinë e vitit në vijim.

Të ardhurat tatimore në vitin 2021 rriten:

- 8,3 % krahasuar me të ardhurat e vitit 2020;

- 3,7 % krahasuar me të ardhurat e vitit 2019.

Rritja e të ardhurave tatimore, për vitin 2021, është parashikuar të vijë nga parashikimi për rritjen ekonomike me rreth 5,5 % dhe përmirësimi në administrimin e të ardhurave, ku komponent kryesor do të jetë procesi i fiskalizimit dhe fatura elektronike, që do të rrisë ndjeshëm kontrollin e transaksioneve dhe detyrimet tatimore që gjenerohen nga këto transaksione.

Argumenti 13.

Politikat fiskale vazhdojnë të jenë të diferencuara si:

- (i) rritja e pagave;*
- (ii) tatim fitimi;*
- (iii) amnistia fiskale; dhe*
- (iii) programimi i investimeve publike.*

Mendimi i Komisionit:

Politika fiskale, në lidhje me tatimet direkte të biznesit, është e diferencuar, pasi ajo synon mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të mesme. Deri në fund të vitit 2020, rreth 73 mijë biznese të vogla dhe të mesme, me xhiro 5 milionë lekë, paguanin 0 % tatim. Për të siguruar mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për të tejkaluar situatën e vështirë ekonomike për shkak të pandemisë, u zerua tatimi mbi fitimin edhe për bizneset e vogla e të mesme me xhiro 5-14 milionë lekë. Krahas 73 mijë bizneseve, rreth 12 mijë biznese të tjera nuk paguajnë tatim mbi fitimin. Kjo masë shkon në favor të mbështetjes, lehtësimit të barrës fiskale dhe ndihmës për biznesin.

Amnistia fiskale nuk është pjesë e buxhetit të vitit 2021. Qeveria shqiptare po diskuton me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e specializuara të kësaj fushe, me qëllim që të gjenden zgjidhjet ligjore adekuate, të cilat ndihmojnë dhe suportojnë ekonominë shqiptare, nëpërmjet mobilizimit të kapitaleve legale të shqiptarëve brenda e jashtë vendit.

Argumenti 14:

Treguesit ekonomikë dhe fiskalë të realizimit të vitit 2020 janë negativë.

Mendimi i Komisionit:

Është tërësisht e qartë që, në një vit të jashtëzakonshëm si viti 2020, ku gjithë bota është zhytur në krizë ekonomike për shkak të pasojave të Pandemisë Covid-19, edhe Shqipëria do të vuante pasojat e saj, pasi jemi pjesë e ekonomisë globale.

Si në çdo vend tjetër të globit, edhe vendi ynë do të ketë rënie të PBB-së në vitin 2020 dhe rrjedhimisht, edhe mosrealizim të të ardhurave buxhetore, krahasuar me projeksionet e buxhetit 2020, të miratuar në tremujorin e fundit të vitit 2019, kur nuk kishte filluar ende të flitej për Covid-19 dhe efektet e tij mbi ekonominë botërore. Problematikat buxhetore për shkak të pandemisë u adresuan nëpërmjet akteve normative.

Të ardhurat tatimore të buxhetit, në vitin 2020, parashikohet të realizohen në nivelin rreth 98% krahasuar me parashikimin sipas aktit normativ të korrikut 2020. Deri në fund të muajit nëntor 2020 janë arkëtuar në buxhet 360 miliardë lekë të ardhura tatimore ose 97,7 % e programit.

Nisur nga shifrat e buxhetit faktik 11 mujor, të ardhurat tatimore në vitin 2020 pritet të jenë sa 25,7 % e PBB-së, krahasuar me 25,4 % në vitin 2019 dhe 26,3 % që janë parashikuar në vitin 2021. Rritja e parashikuar e të ardhurave tatimore në vitin 2021 do jetë 0,6 % e PBB-së. Edhe të ardhurat totale të buxhetit 2021, krahasuar me buxhetin 2020, janë parashikuar me rritje 0,6 % e PBB-së dhe jo 2,5 % sikurse thuhet në arsyetimin e dekretit.

Argumenti 15:

Parashikimet e treguesve ekonomikë dhe fiskalë në buxhetin e vitit 2021 mbeten jorealiste.

Mendimi i Komisionit:

Parashikimet e treguesve të të ardhurave tatimore të buxhetit 2021 janë realiste dhe mbështeten në analizën e treguesve sipas viteve dhe parashikimin e një situatë sa më reale për këtë vit.

Të ardhurat totale të buxhetit parashikohet të rriten 8,2 % në krahasim me të pritshmin e vitit 2020, ndërkohë që vetëm rritja ekonomike e projektuar është 5,5 %.

V. Përfundim.

Në përfundim, duke analizuar dhe argumentuar se ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe se ky ligj do të ndikojë pozitivisht në ringjallërimin e ekonomisë dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit, Komisioni e rrëzoi dekretin nr.11 866, datë 11.12.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

RELATORI
Anastas ANGJELI

KRYETARJA
Milva EKONOMI